

20252464785

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 39 paragrafi (1) të Ligjit për arsimin e mesëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 229/20, 78/25 dhe 132/25), ministri i arsimit dhe shkencës, miratoi

RR E G U L L O R E

PËR MËNYRËN E PARAQITJES, DHËNIES, PËRSHTATJES PËR NXËNËSIT ME AFTËSI TË VEÇANTA, ORGANIZIMIT TË DHËNIES DHE VLERËSIMIT TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE, MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE DHE MATURËS SHTETËRORE TË ARTEVE

I. DISPOZITË E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përshkruhet mënyra e paraqitjes, dhënies së provimeve, përshtatjes për nxënësit me aftësi të kufizuara, organizimi dhe vlerësimi i provimeve në maturën shtetërore, maturën shtetërore profesionale dhe maturën shtetërore të arteve.

II. PARAQITJA E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE, MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE DHE MATURËS SHTETËRORE TË ARTEVE

Neni 2

(1) Për dhënien e maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit në afatin e qershorit, kandidati paraqitet duke parashtruar fletëparaqitje në shkollën ku është i regjistruar, më së voni deri më 31 dhjetor të vitit shkollor në vijim.

(2) Të dhënat për kandidatët e paraqitur, nga Komisioni Shkollor i Maturës (në tekstin e mëtejme: KSHM), regjistrohen në bazën e të dhënave për maturën shtetërore, maturën shtetërore profesionale dhe maturën shtetërore të artit (në tekstin e mëtejme: baza e të dhënave), më së voni deri më 20 janar të vitit shkollor në vijim.

(3) Për kandidatët e paraqitur, Qendra Shtetërore e Provimeve (në tekstin e mëtejme: QSHP) dorëzon lista me të dhëna te KSHM, më së voni deri më 1 shkurt të vitit shkollor në vijim.

(4) KSHM dorëzon listat e konfirmuara me të dhënat e kandidatëve të paraqitur te QSHP, më së voni deri më 20 shkurt të vitit shkollor në vijim.

(5) Për dhënien e maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit në afatin e gushtit, kandidati paraqitet duke dorëzuar fletëparaqitje në shkollën ku është i regjistruar, më së voni deri dy ditë pas ditës së shpalljes së rezultateve përfundimtare të afatit të qershorit.

(6) Për dhënien e maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit në afatin e gushtit, kandidati i cili i ka anuluar rezultatet e provimit/provimeve, paraqitet në shkollën ku është i regjistruar më së voni dy ditë nga dita e anulimit të rezultateve të afatit të qershorit, por jo më vonë se pesë ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të afatit të qershorit.

(7) Të dhënat për kandidatët e paraqitur për provimet në afatin e gushtit, nga KSHM, regjistrohen në bazën e të dhënave në QSHP-së më së voni një ditë pas përfundimit të paraqitjes. Për kandidatët e paraqitur, QSHP dorëzon lista me të dhëna te KSHM më së voni katër ditë pas përfundimit të paraqitjes. KSHM dorëzon listat e konfirmuara për të gjithë kandidatët e paraqitur në QSHP, më së voni një ditë pas pranimit të listave të dorëzuara.

Neni 3

(1) Kandidati bashkë me fletëparaqitjen dorëzon dëftesë për përfundimin e vitit të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të arsimit, si dëshmi për plotësimin e kushteve për dhënien e maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit, një ditë para dhënies së provimit të parë ekstern, dhe të njëjtat dorëzohen te Komisioni Shkollor i Maturës (KSHM).

(2) Dëshmitë nga paragrafi (1) i këtij neni nuk kërkohen për dhënien e detyrës projektuese.

Neni 4

(1) Në qoftë se kandidati, për arsye të justifikuara nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk e ka paraqitur me kohë provimin, Komisioni Shkollor i Maturës (KSHM), mbi bazën e dëshmive me shkrim për arsyetimin e atyre arsyeve, mund t'i mundësojë paraqitjen e provimit më së voni deri më 20 shkurt të vitit aktual shkollor për afatin e qershorit dhe një ditë pas përfundimit të afatit të paraqitjes për afatin e gushtit.

(2) Arsye të justifikuara për mosparaqitjen në kohë të provimeve në maturën shtetërore/maturën shtetërore profesionale/maturën shtetërore të artit janë:

- sëmundje ose trajtim mjekësor;
- rrethana të jashtëzakonshme: fatkeqësi natyrore, aksident i kandidatit ose i një anëtarit të ngushtë të familjes, aksident trafiku me pasoja më të rënda;
- arsye të tjera të justifikuara (gara ndërkombëtare, konkurse, paraqitje publike jashtë vendit etj.).

(3) Kandidati, për arsyet nga paragrafi (2) i këtij neni, duhet të dorëzojë dëshmi me shkrim te KSHM-ja.

Neni 5

Kandidati me statusin nxënës i çrregullt paraqitet në një shkollë që realizon planin dhe programet mësimore sipas të cilave ai është arsimuar më parë, në pajtim me nenin 2 paragrafët (1) dhe (6) të kësaj rregulloreje.

III. DHËNIA E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE / MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE / MATURËS SHTETËRORE TË ARTIT

Neni 6

(1) Matura shtetërore, matura shtetërore profesionale dhe matura shtetërore e artit jepen në përputhje me Konceptin për provimet në përfundim të arsimit të mesëm (në tekstin e mëtejshmë: Koncepti).

(2) Matura shtetërore / matura shtetërore profesionale / matura shtetërore e artit jepet në dy afate provimesh: afatin e qershorit dhe afatin e gushtit.

(3) Kandidati që e jep maturën shtetërore / maturën shtetërore profesionale / maturën shtetërore të artit për herë të parë, paraqet të gjitha provimet sipas Konceptit.

(4) Provimet e maturës shtetërore / maturës shtetërore profesionale / maturës shtetërore të artit, të cilat kandidati nuk i ka kaluar, ai i jep në afatet e ardhshme të provimeve, përveç rasteve kur i është shqiptuar masa e anulimit të provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore / maturës shtetërore profesionale / maturës shtetërore të artit në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm.

(5) Kandidati me aftësi të kufizuara mund ta japë maturën shtetërore / maturën shtetërore profesionale / maturën shtetërore të artit pjesë-pjesë (në qershor dhe në gusht).

Neni 7

Terminet për dhënien e provimeve të maturës shtetërore / maturës shtetërore profesionale / maturës shtetërore të artit publikohen në tabelën e shpalljeve të shkollës, më së voni një muaj para fillimit të dhënies së provimeve të maturës shtetërore / maturës shtetërore profesionale / maturës shtetërore të artit.

Neni 8

- (1) Kandidati në një ditë mund të japë maksimumi një provim.
- (2) Provimet e maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit mund të organizohen edhe të shtunën.

Neni 9

(1) Në qoftë se kandidati për arsye të justifikuara e ka ndërprerë provimin ose nuk mund të marrë pjesë në provimin e maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit, KSHM-ja (Komisioni Shkollor i Maturës) bazuar në dëshmitë me shkrim, mund t'i mundësojë atij të japë provimin në të njëjtën afat të provimit.

(2) Arsye të justifikuara për mos pjesëmarrje ose ndërprerje të provimit ose maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit janë:

- sëmundja ose trajtimi mjekësor;
- rrethana të jashtëzakonshme: ekzistimi i shpallur i gjendjes së krizës, shpallja e epidemisë, përkatësisht pandemisë, zjarret, përmbytjet ose fatkeqësi të tjera natyrore të mëdha;
- rast aksidental që i ka ndodhur kandidatit ose anëtarit të ngushtë të familjes;
- arsye të tjera të justifikuara (gara ndërkombëtare, konkurse, paraqitje publike jashtë shtetit e ngjashëm).

(3) Kandidati për arsyet nga paragrafi (2) i këtij neni duhet të paraqesë dëshmi me shkrim në KSHM.

(4) Rastet nga paragrafi (2) i këtij neni nuk vlejnë për provimet eksterne, përveç në rast të rrethanave të jashtëzakonshme (ekzistim i shpallur i gjendjes së krizës, shpallja e epidemisë, përkatësisht pandemisë, zjarret, përmbytjet ose fatkeqësi të tjera natyrore të mëdha).

(5) Në rastet nga paragrafi (2) alineja 2 e këtij neni, kandidati pas paraqitjes së dëshmisë me shkrim të lëshuar nga institucioni përkatës në KSHM, e jep provimin në termin shtesë.

Neni 10

(1) Nga ana e komisioneve lëndore për maturë shtetërore, për çdo vit shkollor, për provimet eksterne përgatiten detyra provuese të mjaftueshme për të paktën tre komplete provimi për maturë shtetërore, maturë shtetërore profesionale dhe maturë shtetërore të artit.

(2) Nga ana e kryetarëve të komisioneve lëndore të maturës shtetërore, nga detyrat e provimit përgatiten nga tre komplete për maturë shtetërore/maturë shtetërore profesionale/maturë shtetërore të artit, në të cilat përfshihet testi për afatin e qershorit, testi për afatin e gushtit dhe testi rezervë.

(3) Çdo komplet provimi për provimin ekstern përbëhet nga testi, fletët e përgjigjeve dhe udhëzimi për vlerësim.

(4) Kompletet e provimit sipas lëndëve përkatëse, nga ana e kryetarëve të komisioneve shtetërore të maturës dorëzohen në QSHP.

(5) Nga ana e QSHP-së, më së voni dy orë, e më herët 24 orë para fillimit të provimit të lëndës përkatëse, dorëzohet materiali i provimit për atë lëndë në numrin e nevojshëm të kopjeve të kryetari i KSHM-së.

(6) Nga ana e komisionit lëndor shkollor, për çdo vit shkollor përgatiten nga tre komplete provimi për provimin e brendshëm (intern) të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit bazuar në programin e provimit të lëndës përkatëse (një komplet provimi për afatin e qershorit, një për afatin e gushtit dhe një komplet rezervë).

(7) Nga ana e kryetarit të komisionit lëndor shkollor, kompletet e provimit dorëzohen te kryetari i KSHM-së, tre ditë para fillimit të provimit.

(8) Një komplet provimi për provimin intern përbëhet nga testi, udhëzimi për vlerësim dhe shkallët për shndërrimin e pikëve në nota.

(9) Kryetari i KMM-së kujdeset për mbrojtjen e fshehtësisë së materialit të provimit dhe për sigurimin e numrit të nevojshëm të testeve dhe udhëzimeve për vlerësim.

Neni 11

(1) Maturën shtetërore, maturën shtetërore profesionale dhe maturën shtetërore të artit, kandidati e jep në shkollën ku ka përfunduar vitin e fundit të arsimit ose në një lokacion të përcaktuar nga QSHP-ja.

(2) Kandidati me diplomë ose dëftesë të nostrifikuar, maturën shtetërore/maturën shtetërore profesionale/maturën shtetërore të artit e jep në shkollën ku është paraqitur ose në një lokacion të përcaktuar nga QSHP-ja.

(3) Për provimet eksterne për të cilat numri i kandidatëve të paraqitur sipas llojit të provimit në përfundim të arsimit të mesëm në atë shkollë është më i vogël se 45, provimi mund të organizohet në një lokacion tjetër të përcaktuar nga QSHP-ja.

Neni 12

(1) Kandidati, më së voni një muaj para fillimit të afatit të provimit të qershorit, njihet me procedurat për realizimin e provimeve.

(2) Kryetari i KSHM-së kujdeset për informimin e saktë dhe me kohë të kandidatëve.

Neni 13

(1) Kandidati që ka përfunduar vitin e katërt, por nuk ka kaluar maturën shtetërore/maturën shtetërore profesionale/maturën shtetërore të artit, mund ta japë maturën shtetërore/maturën shtetërore profesionale/maturën shtetërore të artit në vitet e ardhshme shkollore.

(2) Kandidatëve që më parë kanë kaluar maturën shkollore në gjimnaze ose maturën shkollore në arsimin artistik ose provimin përfundimtar në arsimin profesional, e që në vitet e ardhshme i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit, u njihen si të kaluara detyra projektuese, si dhe provimet e interne (të brendshme) nga lëndët profesionale që bazohen në të njëjtin program provimi për të njëjtën lëndë në maturën shtetërore/maturën shtetërore profesionale/maturën shtetërore të artit.

(3) Kandidatëve që e kanë kaluar detyrën projektuese, por nuk e kanë përfunduar vitin e katërt të arsimit të mesëm, detyra projektuese u njihet si e kaluar.

Neni 14

(1) Në raste të jashtëzakonshme të pamundësisë për të filluar provimin ekstern në kohën e caktuar, KSHM-ja mund ta shtyjë fillimin e provimit më së shumti deri në 30 minuta dhe për këtë njoftohet QShP-ja.

(2) Në rast të rrethanave të paparashikuara para fillimit të provimit, nga ana e QShP-së mund të vendoset që provimi të fillojë me vonesë më të madhe se 30 minuta nga koha e përcaktuar më parë.

(3) Në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, testuesi kujdeset që kandidatët të mos e braktisin ambientin ku janë të sistemuar.

Neni 15

(1) Për kandidatët që japin provim ekstern me shkrim, sistemi i shpërndarjes së kandidatëve sipas ambienteve përgatitet nga QSHP-ja.

(2) Të dhënat për shpërndarjen e kandidatëve sipas ambienteve publikohen nga KSHM në tabelën e shpalljeve të shkollës ose në një vend tjetër të dukshëm dhe të qasshëm për kandidatët, një ditë para fillimit të provimit.

(3) Të dhënat për shpërndarjen e kandidatëve sipas ambienteve, deri në publikimin e tyre në tabelën e shpalljeve ose vendin tjetër të dukshëm, ruhen si sekret.

(4) Nga ana e KSHM-së, për provimet e interne me shkrim, më së voni një javë para provimit bëhet shpërndarja e kandidatëve sipas ambienteve.

(5) Listat e shpërndarjes së kandidatëve sipas ambienteve nga paragrafi (4) i këtij neni, për çdo provim veçmas publikohen nga KSHM-ja në tabelën e shpalljeve të shkollës ose në një vend tjetër të dukshëm dhe të qasshëm për kandidatët, një ditë para provimit.

Neni 16

(1) Ambientet ku zhvillohet provimi duhet të jenë të përgatitura për provim të paktën 12 orë para fillimit të provimit.

(2) Nga ambientet duhet të hiqen të gjitha mjetet mësimore dhe ndihmat mësimore.

(3) Për çdo kandidat sigurohen një bankë dhe një karrige. Distanca ndërmjet dy kandidatëve nuk duhet të jetë më e vogël se 1,5 metra. Të gjitha bankat duhet të jenë të orientuara në të njëjtin drejtim.

(4) Nga ana e KSHM-së, më së voni një javë para provimit të intern, bëhet shpërndarja e testuesve sipas ambienteve. Për çdo 15 kandidatë caktohet nga një testues.

(5) Ambientet ku zhvillohet provimi duhet të jenë të mëdha, të ndriçuara mirë, të dukshme dhe me së paku 30 vende pune.

(6) Kandidati duhet të ketë me vete dokument identifikimi – letërnjoftim, pasaportë ose legjitimin të nxënësit me fotografi dhe vulën e shkollës së tij amë.

(7) Kandidatit që ka harruar të marrë me vete dokumentin e identifikimit, i mundësohet të japë provimin, për çka testuesi rezervë e njofton kryetarin e KSHM-së. Kryetari i KSHM-së kontakton me prindërit/kujdestarët e kandidatit me kërkesën që dokumenti i nevojshëm të sillet më së voni 30 minuta para përfundimit të provimit, përndryshe provimi i kandidatit nuk do të njihet.

(8) Kandidatët duhet të kenë me vete pajisje shkrimi (stilolaps që shkruan me ngjyrë blu) dhe mjete të tjera të parapara në programin e provimit për lëndën përkatëse.

(9) Kandidatët brenda hapësirës së provimit i vendosin sendet e tyre personale në një vend të caktuar për këtë qëllim. Gjatë provimit testuesit dhe kandidatëve u ndalohet përdorimi i telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike.

Neni 17

(1) Testuesi e hap materialin e mbyllur të provimit para kandidatëve.

(2) Kandidatët duhet t'i dëgjojnë udhëzimet e testuesit dhe të punojnë në mënyrë të pavarur.

(3) Përveç kandidatëve dhe testuesve, në provim mund të marrin pjesë edhe persona të tjerë që kanë autorizim me shkrim nga QShP-ja.

- (4) Personat nga paragrafi (3) i këtij neni ndjekin tërë rrjedhën e provimit ose një pjesë të tij.
- (5) Kandidatit që është vonuar më shumë se 15 minuta nga fillimi i provimit, nuk i lejohet të japë provimin.
- (6) Kandidatit që është vonuar më pak se 15 minuta nga fillimi i provimit, i lejohet të japë provimin, por koha e provimit nuk i zgjatet.
- (7) Gjatë provimit, kandidati mund të braktisë ambientin e provimit vetëm një herë dhe jo më shumë se pesë minuta, në prani të testuesit rezervë.
- (8) Më shumë se një kandidat nga grupi për të cilin është përgjegjës një testues nuk mund të braktisë ambientin në të njëjtën kohë.
- (9) 30 minutat e para nga fillimi i provimit dhe 15 minutat e fundit para përfundimit të provimit, kandidati nuk mund ta braktisë ambientin e provimit.
- (10) Kandidati mund ta përfundojë provimin në çdo kohë, përveç periudhave të cekura në paragrafi (9) të këtij neni, dhe pas dorëzimit të materialit të provimit testuesi mund të largohet nga ambienti.
- (11) Provimi përfundon në kohën e paraparë saktësisht, sipas kohëzgjatjes së provimit.
- (12) Pas përfundimit të provimit, testuesi i kontrollon, i paketon dhe i dorëzon materialet e provimit sipas udhëzimeve të marra.
- (13) Testuesi përgatit raport për të gjithë rrjedhën e provimit dhe plotëson formularët përkatës.

Neni 18

- (1) Temën e detyrës projektuese kandidati mund ta propozojë vetë ose në konsultim me mësimdhënësin-mentor, në përputhje me kriteret e vlerësimit të detyrës projektuese në programin e provimit. Detyra projektuese përgatitet në mënyrë të pavarur nga kandidati, nën udhëheqjen e mësimdhënësit-mentor për detyrën projektuese.
- (2) Kandidati e zgjedh vetë mentorin e detyrës projektuese.
- (3) Mësimdhënësi-mentor për detyrën projektuese mund të ketë nën mentorim maksimum 30 kandidatë.

Neni 19

- (1) Kandidati për detyrën projektuese duhet:
 - më së voni deri në fund të nëntorit të vitit shkollor në të cilin jep maturën shtetërore/maturën shtetërore të artit/maturën shtetërore profesionale, të zgjedhë temën e detyrës projektuese;
 - më së voni deri në fund të marsit të vitit shkollor në të cilin jep maturën shtetërore/maturën shtetërore të artit/maturën shtetërore profesionale, të dorëzojë një kopje të pjesës së shkruar dhe/ose produktit/veprës së përgatitur nga detyra projektuese në formë të shtypur në KSHM dhe në formë elektronike te mentori, i cili pastaj ia dorëzon anëtarëve të tjerë të komisionit për detyrën projektuese.
- (2) Shkolla e arkivon kopjen e dorëzuar të detyrës projektuese të kandidatit në formë të shtypur.

Neni 20

- (1) Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese zhvillohet para komisionit përkatës.
- (2) Për një kandidat, kohëzgjatja e prezantimit dhe mbrojtjes së detyrës projektuese është maksimumi 20 minuta.

Neni 21

- (1) Kandidati që shkel rregullat e dhënies së provimeve të maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale ose maturës shtetërore të artit, mund t'i tërhiqet vërejtja gjatë provimit, të përjashtohet nga provimi, t'i anulohet provimi dhe t'i anulohet provimi me ndalesë për dhënien e provimeve në afatin e njëjtë dhe në afatin e ardhshëm.
- (2) Nën shkelje të rregullave nga paragrafi (1) i këtij neni, nënkuptohen:

- posedimi dhe përdorimi i materialeve të palejuara në ambientin e provimit (fletë letre, telefon celular dhe pajisje të tjera elektronike);
- sjellje e papërshtatshme gjatë provimit (kur kandidati përpiket të ndërpresë provimin, kur një kandidat pengon një kandidat tjetër, ose kur kandidati kërcënon testuesit apo vëzhguesit e provimit);
- shkëmbimi i informatave me ndonjë kandidat tjetër që kanë të bëjnë me provimin;
- kopjimi nga një kandidat tjetër;
- dhënia e provimit në vend të një kandidati tjetër;
- mosdorëzimi i të gjithë ose një pjese të materialit të provimit (testi dhe/ose fleta e përgjigjeve);
- lejimi që puna e tij të përdoret nga një kandidat tjetër;
- shkruarja e shenjave ose përmbajtjeve (të papërshtatshme) në test ose në fletën e përgjigjeve që nuk kanë lidhje me provimin;
- e shkruan identitetin e kandidatit në ndonjë pjesë të testit.

Neni 22

(1) Për shkeljen e rregullave të dhënies së provimeve eksterne të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit, të kryera nga kandidati, shqiptohen masat në vijim, të cilat janë të shkallëzuara:

- vërejtje gjatë provimit;
- ndërprerja e provimit (përfundim nga provimi);
- anulimi i provimit; dhe
- anulimi i provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit në afatin e njëjtë dhe në afatin e ardhshëm të provimeve.

(2) Masa e vërejtjes gjatë provimit shqiptohet në rastet kur kandidati vetëm një herë flet gjatë provimit, kthehet ose përpiket të realizojë kontakt me kandidatët e tjerë.

(3) Masa e ndërprerjes së provimit (përfundim nga provimi) shqiptohet në rastet kur kandidati silllet në mënyrë të papërshtatshme gjatë provimit (kur përpiket ta ndërpresë provimin, kur një kandidat e pengon ose i ndihmon një kandidat tjetër) ose nëse për herë të dytë i është shqiptuar masa nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Testuesi/vëzhguesi i evidenton masat e shqiptuara nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni në Formularin për identifikimin e kandidatëve – Protokoll.

(5) Përgjigjet e kandidatit në test vlerësohen deri në momentin e shqiptuar të masës së ndërprerjes së provimit (përfundimit nga provimi).

(6) Masa e anulimit të provimit shqiptohet në rastet kur kandidati gjatë provimit:

- posedon mjete të palejuara që nuk parashikohen me programin e provimit (fletë, telefon celular ose pajisje të tjera elektronike);
- shkëmben informacione të lidhura me provimin me një kandidat tjetër ose me testuesi n;
- kopjon nga një kandidat tjetër;
- lejon që puna e tij të përdoret nga një kandidat tjetër ose
- nuk e dorëzon të gjithë materialin e provimit (testin dhe/ose fletën e përgjigjeve).

(7) Testuesi/vëzhguesi e evidenton masën e shqiptuar nga paragrafi (6) i këtij neni në Formularin për identifikimin e kandidatëve – Protokoll.

(8) Masa e anulimit të provimit shqiptohet edhe në procesin e vlerësimit kur vlerësuesi i provimit ekstern konstaton se në test:

- kandidati e ka shkruar emrin dhe mbiemrin (ose e ka zbuluar identitetin e tij);
- dy të tretat e përgjigjeve të pyetjeve të hapura me përgjigje të gjatë janë identike me ato të të paktën edhe një kandidat tjetër ose

- është zbuluar plagjiaturë në përgjigjet e pyetjes së hapur me përgjigje të gjatë, nga burime të caktuara ose me përdorim të inteligjencës artificiale.

(9) Vlerësuesi i evidenton shkeljet e rregullave të dhënies së provimeve të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit nga paragrafi (8) i këtij neni në Formularin për evidentimin e parregullsive nga ana e kandidatit.

(10) Përgjigjet e kandidatit, në rast se shqiptohet masa e anulimit të provimit, vlerësohen me zero pikë në të gjithë testin.

(11) Masa e anulimit të provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit në afatin e njëjtë dhe në afatin e ardhshëm të provimeve, shqiptohet në rastet kur kandidati:

- jep provimin në vend të një kandidati tjetër (zëvendësim identiteti) ose
- sillet në mënyrë të papërshtatshme gjatë provimit (kur kërcënon kandidatët e tjerë ose testuesin ose vëzhguesin e provimit).

(12) Përgjigjet e kandidatit, në rast se shqiptohet masa e anulimit të provimit me ndalim të dhënies së provimeve në afatin e njëjtë dhe në afatin e ardhshëm, vlerësohen me zero pikë në të gjithë testin për atë provim dhe kandidatit i ndalohet dhënia e provimeve të mbetura në afatin e njëjtë të provimeve, si dhe i ndalohet dhënia e provimeve të maturës shtetërore në afatin e ardhshëm.

(13) Testuesi/vëzhguesi e evidenton masën e shqiptuar nga paragrafi (11) i këtij neni në Formularin për identifikimin e kandidatëve – Protokoll.

(14) Testuesi/vëzhguesi i evidenton shkeljet e rregullave të dhënies së provimeve të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit në Formularin për identifikimin e kandidatëve – Protokoll.

(15) Propozimin për shqiptimin e masës së anulimit të provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit në afatin e njëjtë dhe në afatin e ardhshëm, e japin testuesi dhe/ose vëzhguesi te QShP.

(16) Nga komisioni për shqiptimin e masave pranë QShP-së, më së voni deri në publikimin e rezultateve preliminare të provimeve eksterne të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit, njoftohet me shkrim KSHM-ja për kandidatin për të cilin është shqiptuar masa nga paragrafi (11) i këtij neni.

(17) Komisioni nga paragrafi (16) i këtij neni përgatit raport me të gjithë kandidatët ndaj të cilëve janë shqiptuar masat nga paragrafët (3), (6), (8) dhe (11) i këtij neni dhe i dorëzon ato te personi përgjegjës në QShP për veprime të mëtejshme.

Neni 23

(1) Për shkeljen e rregullave të dhënies së provimeve të interne të maturës shtetërore, të kryera nga kandidati, shqiptohen masat e mëposhtme, të cilat janë të shkallëzuara:

- vërejtje gjatë provimit;
- ndërprerja e provimit (përfundim nga provimi);
- anulimi i provimit; dhe
- anulimi i provimit me ndalesë për dhënien e provimeve të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit në të njëjtin dhe në afatin vijues të provimeve.

(2) Masa e vërejtjes gjatë provimit shqiptohet në rastet kur kandidati vetëm një herë flet gjatë provimit, kthehet ose mundohet të kontaktojë me kandidatët e tjerë.

(3) Masa e ndërprerjes së provimit (përfundim nga provimi), me propozim të testuesit, shqiptohet nga KSHM në rastet kur kandidati sillet në mënyrë të papërshtatshme gjatë provimit (kur përpiket ta ndërpresë provimin ose kur një kandidat pengon një kandidat tjetër).

(4) Përgjigjet e kandidatit në test vlerësohen deri në momentin e shqiptimit të masës së ndërprerjes së provimit (përfundimit).

(5) Masa e anulimit të provimit, me propozim të testuesit, shqiptohet nga KSHM në rastet kur kandidati gjatë provimit:

- posedon mjete të palejuara që nuk janë të parapara me programin e provimit (fletë të ndryshme, telefon celular ose pajisje të tjera elektronike);
- shkëmben informacione të lidhura me provimin me një kandidat tjetër ose testuesin;
- kopjon nga një kandidat tjetër;
- lejon që puna e tij të shfrytëzohet nga një kandidat tjetër; ose
- nuk dorëzon të gjithë materialin e provimit.

(6) Masa e anulimit të provimit, me propozim të vlerësuesit, shqiptohet nga KSHM në rastet kur vlerësuesi i provimit konstaton se në test:

- kandidati ka shkruar emrin dhe mbiemrin e tij (ose e ka zbuluar identitetin e tij);
- ka përgjigje identike në pyetjet e hapura me përgjigje të gjatë me të paktën një kandidat tjetër; ose
- është zbuluar plagjiaturë në përgjigjet e pyetjeve të hapura me përgjigje të gjatë nga burime të caktuara ose përmes përdorimit të inteligjencës artificiale.

(7) Përgjigjet e kandidatit në test vlerësohen deri në momentin e shqiptimit të masës së ndërprerjes së provimit (përfundimit nga provimi).

(8) Masa e anulimit të provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit në të njëjtin dhe në afatin vijues të provimeve, me propozim të testuesit, shqiptohet nga KSHM në rastet kur kandidati:

- jep provimin në vend të një kandidati tjetër (zëvendësim identiteti); ose
- sillet në mënyrë të papërshtatshme gjatë provimit (kur kërcënon një kandidat tjetër, testuesin ose vëzhguesin e provimit).

(9) Përgjigjet e kandidatit në rast se shqiptohet masa e anulimit të provimit me ndalim të dhënies së provimeve në të njëjtin dhe në afatin vijues, vlerësohen me zero pikë në të gjithë testin për atë provim, dhe kandidatit i ndalohet dhënia e provimeve të mbetura gjatë të njëjtit afat, si dhe i ndalohet dhënia e provimeve të maturës shtetërore në afatin vijues.

Neni 24

(1) Në qoftë se vëzhguesi konstaton se testuesi nuk vepron në përputhje me nenin 22 të kësaj rregulloreje, ose i ndihmon kandidatit në zgjidhjen e testit, ai e largon testuesin nga hapësira e provimit dhe e zëvendëson me njërin nga testuesit rezervë.

(2) Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, vëzhguesi e informon kryetarin e KSHM-së dhe QShP-në për ndryshimin e kryer të testuesit dhe këtë e evidenton në Formularin për vëzhgimin e maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit.

(3) Vëzhguesi për rastet nga paragrafi (1) i këtij neni përgatit një raport dhe e dorëzon në QShP, më së voni një ditë pas mbajtjes së provimit eksterne të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit.

(4) Nga ana e QShP-së raporti nga paragrafi (3) i këtij neni i dorëzohet punëdhënësit të testuesit, më së voni deri në publikimin e rezultateve përfundimtare.

IV. PËRSHTATJA E MATURËS SHTETËRORE/MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE/MATURËS SHTETËRORE TË ARTIT PËR KANDIDATËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ARSIMIN GJIMNAZIAL, PROFESIONAL DHE ARTISTIK

Neni 25

(1) Nga ana e KSHM-së, për kandidatët me aftësi të kufizuara, përgatitet dhe përshtatet mënyra e realizimit të pjesëve të interne të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit, në konsultim me QShP-në.

(2) Përshtatja e maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit për kandidatët me aftësi të kufizuara duhet të jetë në përputhje me përvojën e tyre të fituar gjatë procesit arsimor.

Neni 26

(1) Provimi për kandidatët me aftësi të kufizuara zgjat maksimum deri në 50% më shumë se koha e paraparë për provimin e lëndës përkatëse.

(2) Nga ana e KSHM-së mund të parashikohet edhe kohë për pushim për kandidatin (pauzë).

(3) Për kandidatët nga paragrafi (1) i këtij neni sigurohet një hapësirë e veçantë provimi. Nëse pyetësi është anëtar i jashtëm, sigurohet edhe një anëtar i brendshëm i komisionit dhe një testues i provimit. Testuesi i provimit kujdeset që të mos prishet rendi i provimit.

Neni 27

Për kandidatët me aftësi të kufizuara realizohen përshtatjet në vijim:

- përshtatje teknike e materialit të provimit;
- dhënie e provimit me ndihmës;
- përdorim i mjeteve të veçanta ndihmëse;
- provim i përshtatur me përdorimin e alfabetit Braille dhe/ose gjuhës së shenjave;
- përgatitje e përshtatur e detyrës projektuese dhe vlerësimi i saj.

Neni 28

(1) Kandidati me aftësi të kufizuara mund të lirohet nga dhënia e një pjese të materialit të provimit, i cili nuk është i mundur të përshtatet.

(2) Paragrafi (1) i këtij neni zbatohet vetëm për provimet që realizohen në mënyrë interne (të brendshme).

Neni 29

(1) Për kandidatin me pengesa trupore (fizike) ose pengesa të kombinuara, sigurohet një person për lexim dhe shkrim të përgjigjeve (ndihmës). Ndihmësi është një nga anëtarët e komisionit të provimit.

(2) Ndihmësi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të jetë mësimdhënës ose i afërm i kandidatit nga paragraf (1) i këtij neni.

Neni 30

(1) Kandidati me aftësi të kufizuara mund të përdorë kompjuter.

(2) Kandidati nuk mund të ketë qasje në asnjë program që mund t'i mundësojë të kalojë më lehtë provimin. Një kopje e përgjigjeve të kandidatit ruhet në një pajisje të jashtme memoruese, ndërsa një kopje tjetër shtypet, dhe më pas kryetari i komisionit të provimit i fshin përgjigjet e kandidatit nga kompjuteri.

Neni 31

Kandidatit me dëmtim të shikimit (nxënës me shikim të dobët dhe të verbër), mund t'i mundësohet gjatë provimit të përdorë tekst të shtypur me shkronja të mëdha ose alfabet Braille.

Neni 32

Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese duhet të përshtaten në mënyrë që kandidati të mund t'i shfaqë njohuritë dhe aftësitë e tij.

Neni 33

Dispozitat nga nenet 28, 29 dhe 31 të kësaj rregulloreje, zbatohen në mënyrë të adekuate edhe për dhënien e provimeve të maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale dhe maturës shtetërore të artit nga kandidatët që janë në trajtim spitalor më shumë se gjashtë muaj në një institucion shëndetësor.

V. VLERËSIMI I PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE, MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE DHE MATURËS SHTETËRORE TË ARTIT

Neni 34

(1) Verifikimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve nga lëndët mësimore të pjesës së detyrueshme dhe pjesës me zgjedhje të maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale dhe maturës shtetërore të artit realizohet në mënyrë eksterne dhe/ose interne, në pajtim me Konceptin.

(2) Verifikimi dhe vlerësimi i provimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, që realizohen në mënyrë eksterne, kryhet nga vlerësues të jashtëm.

(3) Verifikimi dhe vlerësimi i provimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, që realizohen në mënyrë interne, kryhet nga komisionet lëndore të shkollës, sipas programeve të provimit.

(4) Verifikimi dhe vlerësimi i detyrës projektuese në gjimnaze, arsimin profesional dhe artistik realizohet në mënyrë interne, para komisionit përkatës të shkollës, sipas programeve të provimit.

Neni 35

(1) Vlerësimi i njohurive dhe aftësive të kandidatëve në provimet interne dhe eksterne të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit bëhet me pikë, të cilat më pas shndërrohen në nota nga një (1) deri në pesë (5) për provimet interne, ndërsa për provimet eksterne në nota dhe në rang percentil.

(2) Të gjitha notat janë kaluese, përveç notës një (1).

(3) Vlerësimin për provimet eksterne e kryejnë vlerësues të cilët caktohen dhe trajnohen nga QShP-ja, të cilët janë nga radhët e mësimdhënësve të shkollave të mesme që realizojnë mësim në lëndën që vlerësohet.

(4) Përjashtimisht, nëse për vlerësues nuk sigurohet mësimdhënës nga shkolla e mesme, caktohet mësimdhënës nga shkolla fillore, i cili ka përfunduar arsimin e lartë dhe realizon mësim në lëndën që vlerësohet.

Neni 36

(1) Prag-propozimi për notën kaluese (2) dhe për notën të shkëlqyer (5) për secilin provim ekstern përcaktohet nga komisionet profesionale pas përfundimit të provimit, në pajtim me procedurat për organizimin dhe realizimin e pjesës eksterne të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit.

(2) Komisionet profesionale për përcaktimin e propozimit-pragut të kalueshmërisë për një lëndë të caktuar mësimore, zakonisht përbëhen nga tre anëtarë të komisioneve lëndore të maturës shtetërore dhe tre vlerësues. Për lëndët ku janë paraqitur më pak se 50 kandidatë, komisionet profesionale mund të kenë edhe numër më të vogël anëtarësh.

(3) Jo më vonë se 15 ditë nga dita e përfundimit të vlerësimit të provimeve eksterne të maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale ose maturës shtetërore të artit, nga komisionet profesionale për përcaktimin e pragut të kalueshmërisë për secilin provim ekstern, dorëzohen te Bordi Shtetëror i Maturës propozimet e pragjeve të kalueshmërisë.

(4) Detyra projektuese vlerësohet nga komisioni shkollor për detyrën projektuese, në mënyrë që faza përgatitore dhe faza e realizimit të vlerësohen nga mësimdhënësi-mentor, ndërsa faza e prezantimit dhe mbrojtjes nga dy anëtarët e tjerë të komisionit.

(5) Në vlerësimin e detyrës projektuese, mësimdhënësi-mentor merr pjesë me 50%, ndërsa dy anëtarët e tjerë me 25%.

(6) Notat jepen në mënyrë numerike dhe përshkruese (në procesverbal).

Neni 37

(1) Rezultatet preliminare të provimeve eksterne publikohen në faqen zyrtare të QShP-së, më së voni 30 ditë nga realizimi i provimit të fundit ekstern.

(2) Rezultatet e provimeve të maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit ruhen në fshehtësi deri në publikimin e tyre.

(3) Rezultatet përfundimtare publikohen në faqen zyrtare të QShP-së pas shqyrtimit të ankesave.

(4) Rezultatet e provimeve eksterne publikohen nga KSHM-ja në tabelën e shpalljeve të shkollës, një ditë pas pranimit të tyre nga QShP-ja.

(5) Rezultatet e provimeve të brendshme dhe të detyrës projektuese publikohen në tabelën e shpalljeve të shkollës nga KSHM-ja, më së voni tre ditë pas përfundimit të provimit të lëndës përkatëse ose pas mbrojtjes së detyrës projektuese.

(6) Nga ana e KSHM-së publikohen në tabelën e shpalljeve të shkollës edhe rezultatet totale nga të gjitha provimet e maturës shtetërore/maturës shtetërore profesionale/maturës shtetërore të artit.

Neni 38

(1) Kandidati që nuk ka kaluar maturën shtetërore, maturën shtetërore profesionale ose maturën shtetërore të artit, njoftohet për suksesin e arritur në pjesët e veçanta të maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale ose maturës shtetërore të artit.

(2) Provimet në të cilat kandidati nuk ka marrë notë kaluese, i jep në afatet e ardhshme të provimeve dhe, bashkë me fletëparaqitjen për provim, dorëzon vërtetim për provimet e kaluara nga maturën shtetërore/maturën shtetërore profesionale/maturën shtetërore të artit në afatet e mëparshme të provimeve.

Neni 39

(1) Kandidati, në qoftë se konsideron se është bërë gabim në vlerësimin e detyrave të provimit, në përllogaritjen e pikëve ose në nxjerrjen e notës, mund të paraqesë ankesë ndaj vlerësimit të provimit.

(2) Ankesa nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet më së voni dy ditë pas publikimit të rezultateve preliminare të provimit.

(3) Kandidati ankesën për provimet eksterne e dorëzon te KSHM, e cila ankesën ia përcjell QShP-së, më së voni një ditë pas përfundimit të afatit të dorëzimit të ankesave.

(4) Ankesa nga paragrafi (3) i këtij neni shqyrtohet nga komisioni lëndor për ankesa.

(5) Nëse numri i ankesave për një lëndë të caktuar është i madh, mund të formohen më shumë se një komision për ankesa.

(6) Me dorëzimin e ankesës, kandidati bashkëngjit një kopje të pagesës për shpenzimet e shqyrtimit të ankesës.

(7) Nëse komisioni nga paragrafi (4) i këtij neni, pas shqyrtimit të materialit të provimit, konstaton se ankesa e kandidatit është e bazuar, përcakton numrin përfundimtar të pikëve dhe mjetet e paguara i kthehen kandidatit.

(8) Kandidati ankesën për provimet e brendshme e dorëzon te KSHM, e cila e përcjell ankesën te komisioni lëndor i shkollës.

(9) Komisioni lëndor i shkollës e shqyrton ankesën në prani të një anëtar i KSHM-së.

(10) Kandidati njoftohet për rezultatin e ankesës nga paragrafi (9) i këtij neni, më së voni tre ditë nga dita e pranimit të saj.

(11) Nëse komisioni nga paragrafi (8) i këtij neni konstaton se është bërë gabim, atëherë përcakton numrin përfundimtar të pikëve.

(12) Kandidati që ka dorëzuar ankesë, ka të drejtë të shohë testin e vet.

Neni 40

(1) Kandidati që ka kaluar me sukses maturën shtetërore/maturën shtetërore profesionale/maturën shtetërore të artit dhe dëshiron të përmirësojë suksesin nga një ose më shumë lëndë, e jep provimin përsëri në vitin e ardhshëm shkollor.

(2) Kandidati që nuk është i kënaqur me rezultatin e arritur në një lëndë të caktuar, mund të paraqesë kërkesë për riprovim të rezultatit të marrë, pranë KSHM-së, më së voni tre ditë pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga QShP-ja për atë afat provimi dhe për këtë njofton QShP-në.

(3) Në rastin nga paragrafi (2) i këtij neni, kandidatit nuk i lëshohet diploma për arsimin e mesëm të përfunduar.

(4) Kandidati nga paragrafi (2) i këtij neni, e paraqet sërish provimin në shkollën ku ka dhënë maturën shtetërore/maturën shtetërore profesionale/maturën shtetërore të artit, në pajtim me nenin 2 të këtij rregullor, dhe e riprovon atë në afatin e parë të ardhshëm të provimeve.

(5) Për kandidatin nga paragrafi (1) i këtij neni, merret si notë përfundimtare ajo që është arritur në rivlerësim.

(6) Kandidati nga paragrafi (1) i këtij neni ka të drejtë ta përdorë mundësinë e përmirësimit të rezultatit vetëm një herë.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 41

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullorje, pushon të vlejë Rregullorja për mënyrën e dhënies dhe vlerësimit të rezultateve të nxënësve në provimet e maturës shtetërore në gjimnaze, arsimin e mesëm profesional dhe të mesëm të artit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 24/25).

Neni 42

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit të saj në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 18-15176/1
4.12.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Pr.Dr. Весна Јаневска, d.v.